

Seamus Pampuri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



AMENDAMENT

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Znj. Orjola Pampuri propozon,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 11, pas fjalisë “Fondi prej 2 300 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Fondi prej 2.5 miliardë lekësh do të përdoret për rritjen e pagave të të gjithë punonjësve në sektorin e shëndetësisë, me të paktën 20%, duke filluar nga 1 Janari 2023, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN


#### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Vitet e fundit është vërejtur largimi i punonjësve të sektorit të shëndetësisë, veçanërisht i mjekëve dhe infermierëve. Sipas të dhënave statistikore, rezulton që të paktën një mijë mjekë dhe mbi 3500 infermierë janë larguar nga vendi pikërisht për shkak të kushteve të punës. Nga ana tjetër, pandemia dhe agresioni rus në Ukrainë ka sjellë një rritje të përgjithshme të cmimeve me të paktën 20% të shportës së ushqimeve apo transportit me 25%.

Nëse marrim për referencë vendet e rajonit apo edhe më gjërë, rezulton se Shqipëria ka nivelin më të ulët të pagave për personelin mjekësor. Nisur nga kjo situatë shqetësuese, është domosdoshmëri përmirësimi i kushteve të punës, veçanërisht në drejtim të pagave. Vizioni i Partisë Demokratike është dyfishimi i pagave të personelit mjekësor, me qëllim ndalimin e hemoragjisë migratore në këtë sektor. Megjithatë, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së financave publike, propozimi ynë është për vitin 2023 rritja e pagave të jetë 20%, me një fond total shtesë për të gjithë punonjësit shëndetësorë prej 2.5 miliardë lekësh.

Efekti financiar i kësaj rritje mund të përballohet nga rialokimi i fondeve për rikonstrukcione luksoze zyrash, mobilime dhe blerje makinash, fluturime, chartera privatë, akomodimin në hotele etj. Rritja do të fillojë me efekt nga 1 Janari 2023.

**Oriola PAMPURI**



Seance Plenare  
22/11/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



AMENDAMENTE

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja  
Dhurata Çupi,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në tabelën 3 “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2023”, në kolonën  
“Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2023”, vlera “19.509.311 mijë lekë”  
zëvendësohet me “30 miliardë lekë”.

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION


### PËR AMENDAMENTIN

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Nga puna e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale ka rezultuar se për shkak të mungesës së fondeve nga transfertat e pakushtëzuar, bashkitë kanë qenë në pamundësi objektive për të realizuar shërbimet dhe investime ndaj komunitet, sidomos në zonat rurale. Sipas të dhënave të administruara në Komision, rezultojnë një diferencë e madhe ndërmjet shërbimeve dhe investimeve në zonat urbane krahasimisht me zonat rurale.

Me qëllim adresimin e kësaj problematike për t'iu mundësuar organeve të pushtetit lokal të realizojnë të gjitha shërbimet dhe investimet e nevojshme në njësitë administrative që përfshijnë zona rurale, ne propozojmë rritjen me 50% të transfertës së pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2023. Këto fonde janë lehtësisht të rialokueshme nga fondet e dedikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qendrore dhe PPT-të, me mbështetje buxhetore, pa cënuar nivelet e planifikuara të deficitit buxhetor 2023.

**Dhurata ÇUPI**





Seancës Pleurore  
22/11/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:** MBËSHTETJE FINANCIARE PËR STUDENTËT NË  
TABELËN NR.1 ME KODIN 11/09450 ARSIMI I  
LARTË, ARTIKULLI 606.

**KËRKUES:**

**Znj. Erisa Xhixho**

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN  
PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

**BAZA LIGJORE:**

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Studentët sot përballen me krizën e rritjes së çmimeve. Qiratë e banesave që arrijnë në 300-400 euro në muaj, transporti publik, rritja e çmimit të ushqimeve dhe veshjeve e kanë shtuar koston e jetesës, duke e bërë të papërballueshme për ta dhe familjet e tyre. Të gjetur në këto kushte, në shtator, ata iu drejtuan Ministrisë së Arsimit me një peticion me 6 mijë firma, me anë të të cilit kërkuan mbështetje financiare me 100 euro në muaj ( 12.000 lekë) , sa bashkëmohatarët e tyre në Kosovë, për të lehtësuar sadopak barrën financiare.

Studentët janë një nga shtresat që po vuajnë më shumë krizën ekonomike që po kalon vendi dhe në të dy aktet normative të Paketës së Rezistencës, ata nuk janë mbështetur. Ndaj me qëllim që t’u vihet në ndihmë në kushtet e krizës së çmimeve për një periudhë nga janari–qershor 2023, propozoj mbështetje financiare në masën 12.000 lekë në muaj për studentët, që duhet të sistemohet në


tabelën 1 të ligjit, grupi 11, programi 09450 Arsimit i Lartë, artikulli 606 (mbështetje në formë burse).

**PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: “Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”, paraqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar arsimin si prioritet kombëtar dhe me bindjen e plotë se vetëm investimi në edukim mund të frenojë largimin e të rinjve, pedagogëve dhe intelektualëve nga vendi, gjithashtu duke adresuar mbajtjen e premtimeve elektorale të qeverisë për ta çuar buxhetin e arsimit në 5% e PPB-së, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

**DEPUTETI:**

ERISA XHYHO 

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

## **ANEKSI 1**

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2023 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në nenin 1, "Për buxhetin e vitit 2023", në tabelën Nr. 1, të ligjit, grupi 11, Programi 09450, arsiri i lartë, artikulli 606, të shtohet vlera 12.000 lekë në muaj, për periudhën janar-qershor 2023, (mbështetje në formë burse) me qëllim rritja e mbështetjes financiare për studentët

Jeanes Pleuare  
22/11/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:** RRITJA E PAGAVE TË MËSUESVE NË TABELËN NR. 1 TË BUXHETIT NË KODIN 11/09120 DHE NË KODIN 11/09230

**KËRKUES:** Znj. Erisa Xhixho  
Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:** “PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

**BAZA LIGJORE:** Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Shqipëria është në një krizë shumë të rëndë ekonomike dhe sociale. Kriza e besimit ndaj institucioneve po i detyron qytetarët të largohen çdo ditë. Ky fenomen më së shumti ndihet në shkollat dhe universitetet tona, ku numri i nxënësve sipas relacionit dhe studentëve ulet në mënyrë progresive çdo vit. Sektori i arsimit është një ndër sektorët më të nënvlerësuar, pa investim dhe pa vizion serioz. Kur krahasohen buxhetet, pagat e programet e Shqipërisë me vende të tjera të rajonit, ne vazhdimisht zëmë vendin e fundit.

Në raportin e fundit të Komisionit European, mësuesit shqiptarë rezultojnë më të keqpaguearit në Europë, me vetëm 4 233 € në vit. Sipas raportit të përpiluar nga Komisioni European/EACEA/Eurydice, mësuesit shqiptarë janë më të keqpaguearit edhe në rajon.

Në Mal të Zi, një mësues paguhet 9 983 euro, në Maqedoninë e Veriut 7 291 euro, në Serbi 6 646 euro dhe në Bosnje-Hercegovinë 6 120 euro në vit.



Këto amendime kanë qellim të rrisin buxhetin e arsimit parauniversitar, me synim kthimin e arsimit në prioritet kombëtar dhe investimin në kapitalin njerëzor, që përbën edhe shtyllën e shoqërisë shqiptare.

Rritja prej vetëm 6% në korrik 2023 e pagës së mësuesve të arsimit parauniversitar është e pamjaftueshme së pari për të indeksuar rritjen e çmimeve që do të sjellë rritjen e kostos së jetesës, dhe së dyti rritjen reale për të përmirësuar mirëqenien e tyre.


Ndaj, në zërin shpenzime korrente për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm shtohen gjithsej 1.3 miliard lek (12% rritje e pagës), respektivisht shtesa duhet të akomodohet në tabelën I të ligjit në zërin e shpenzimeve të personelit të programit 'Arsimi Bazë', 09120, në masën I miliard lekë (600+601) dhe 300 milionë lekë (600+60) në programin "Arsimi i mesëm", me kod programi 09230. Kjo rritje bëhet me qëllim rritjen e pagës së mësuesve dhe financimin e programeve të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *"Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t'u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë",* paraqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar arsimin si prioritet kombëtar dhe me bindjen e plotë se vetëm investimi në edukim mund të frenojë largimin e të rinjve, mësuesve dhe intelektualëve nga vendi, njëkohësisht duke adresuar mbajtjen e premtimeve elektorale të qeverisë për ta çuar buxhetin e arsimit në 5% të PPB-së, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

**DEPUTETI:**



(emër, mbiemër, nënshkrimi)


## **ANEKSI 1**

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2023 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në Nenin 1, Për buxhetin e vitit 2023", në Tabelën Nr. 1 të Buxhetit, në Kodin 11/09120 të shtohet vlera 1 miliard lekë dhe në Kodin 11/09230 të shtohet vlera 300 Milionë Lekë.

Seances Pleuro  
22/11/2022  
*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:** “RRITJA E PAGAVE TË PERSONELIT  
MJEKËSOR, TABELA 5 TË PROJEKT BUXHETIT”

**KËRKUES:** Z. PETRIT VASILI  
Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:** “RRITJA E PAGAVE TË PERSONELIT  
MJEKËSOR, TABELA 5 TË PROJEKT BUXHETIT”

**BAZA LIGJORE:** Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Personeli mjekësor në Shqipëri i përbërë nga mjek, infermier dhe personel ndihmës është përballur në këto dy vitet e fundit me problematika shumë kritike siç ishte pandemia e COVID-19.

Kjo situatë e jashtëzakonshme vuri në dukje edhe problematikën shumë serioze të nivelit të pagesës së personelit mjekësor në raport me ngarkesën shumë të lartë të punës që ai përballon dhe pagesën tepër të ulët që ai merr për këtë shërbim.

Një situatë e tillë po rëndohet gjithnjë e më shumë duke vlerësuar dhe rritjen e shpejtë të kostos të jetesës e në radhë të parë rritjen e çmimeve të produkteve bazë, por edhe të mjaft shërbimeve të tjera, është vendi të kujtojmë se personeli mjekësor shqiptar është absolutisht ndër më të keqpaguarit në Europë por ashtu edhe në raport me vëndet e Ballkanit.

Një situatë e tillë sigurisht që nuk mund të vazhdoj më dhe ajo kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Rritja e pagave e parashikuar nga Qeveria vetëm në nivelin e 6% është një rritje krejtësisht e

pandjeshme që nuk i përgjigjet as nivelit të inflacionit i cili në një muaj më parë është deklaruar në masën 8.64%.

Personeli mjekësor nuk ka nevojë për propagandën e pafund të Qeverisë, por kërkon mbështetje konkrete.

Ndaj, propozojmë që rrija në total për vitin 2023 të jetë në masën 12%, pra duke e rritur edhe me 6% të tjera në raport me propozimin e Qeverisë.

Kjo rritje ndonëse e kufizuar, së paku do të amortizonte terësisht pasojat inflacionit por edhe do të shënonte një rritje të pagës reale që merr personeli mjekësor nw terësi.

Masa e rritjes është në nivelin e 1.1 miliard lek dhe sigurisht është krejtësisht e përballueshme nga buxheti i shtetit pasi e përkthyer në terma real, do të ishte më pak se 0.5 km rrugë nga ato që Qeveria tenderon apo koncesionon në mënyrë të përditshme.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”*, paraqes amendamentin bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shëndetësinë si një prioritet kombëtar e të patjetërsyeshme dhe investimi në të si investim në të mirë të shëndetit të popullit shqiptar, si dhe duke vlerësuar që vetëm marrja e masave të shpejta për një pagë dinjitoze do të mund të ndal largimin masiv të mjekëve dhe infermierëve nga Shqipëria, propozoj këtë rritje prej 6% më shumë se sa parashikimi i sjellë në Projekt Buxhetin e Qeverisë, propozoj për miratim në seancë plenare amendamentin që vijon:

**PETRIT VASILI**

Në Projekt - Ligjin “Për Buxhetin e vitit 2023, të bëhen ndryshimet si vijon:

**Neni 1**

Në Tabelën Nr. 1, të Projekt- Ligjit , Grupi 13, në Programin 07/220, “Shërbimet e Kujdesit Parësor”, Artikulli 604, bëhet një shtesë në masën 330 milion lek dhe në Programin 07/330 “Shërbime të Kujdesit Dytësor” në Artikullin 604 bëhet një shtesë në masën 770 milion lek.



Seance Plene  
22/11/2022



KUVENDI  
NR 3937 DATE 22.11.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**TITULLI I AMENDAMENTIT:** RITJA E SHPENZIMEVE KORRENTE NË TABELËN NR.1, NË KODIN 11/09450 DHE NË KODIN 11/09770, ME QËLLIM RITJEN E GRANTEVE NË MËSIMDHËNIE DHE NË KËRKIME SHKENCORE.

**KËRKUES:**

Znj. Erisa Xhixho

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:**

“PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

**BAZA LIGJORE:**

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Pedagogët dhe studentët janë prej javësh në protesta për arsim cilësor. Protesta është organizuar nga Sindikata Kombëtare e Pedagogëve, e cila ka hartuar një peticion, ku parashtrihen kërkesat për paga dinjitoze për pedagogët dhe stafin akademik, rritje të financimit për kërkimin shkencor, ndaj dhe për plotësimin e kërkesave të tyre të drejta nevojitet ndryshim real buxhetor.

Në Shqipëri, paga e një profesori nuk i kalon 1 mijë euro, ndërsa në Kosovë një pedagog paguhet mesatarisht 1400-1500 euro.

Pedagogët kërkojnë rritjen e pagës në masën 50% për 2 vjet, në mënyrë që të arrijnë në nivelin e kolegëve të tyre në Kosovë brenda dy viteve të ardhshme.

Kjo kërkesë e drejtë e tyre nuk është parashikuar të përmbushet në projekt-buxhetin e vitit 2023. Ndaj, me qëllim rritjen e pagave të pedagogëve sipas kërkesave të tyre, propozoj që të rriten pagat e pedagogëve 30% në vitin 2023 dhe 20% në vitin 2024.

Në rritjen 30% të viti 2023 duke konsideruar që është bërë një rritje 7% të pagave, kërkoj rritjen edhe për 23% të barabartë me një **fond vjetor 1.48 miliard lekë**.

Kërkimi shkencor vazhdon të jenë i nënfinancuar. Në progres-raportin e fundit të Bashkimit Europian thuhet: *Sa i përket fondeve të kërkimit shkencor, Shqipëria akordoi shumë më poshtë se 1% PPB-së, e synuar deri në vitin 2022.*

Me qëllim shtimin e projekteve të kërkimit shkencor, ngritjen e laboratorëve modernë të kërkimit shkencor, propozohet që në zërin për kërkimin shkencor të shtohet vlera prej **5 miliardë lekë**.

Kërkimi shkencor nuk është domosdoshmëri vetëm për akademikët dhe studentët, por prej tij përfiton e gjithë shoqëria. Kërkimi shkencor duhet të kthehet në një nga misionet kryesore të universiteteve dhe qeverisë, përmes investimit dhe krijimit të hapësirave të nevojshme, në mënyrë që përmes tij të garantohet së pari mësimdhënie shumë më cilësore dhe më tej aplikimi i rezultateve në një sërë fushash në kuader edhe të sfidës për ndërkombëtarizimin e Universiteteve tona.


Në kohën kur të rinjtë po largohen masivisht nga vendi, arsyet përveç atyre ekonomike dhe të papunësisë, është dhe arsimi cilësor që ofrohet në vendet e Bashkimit Europian, ndaj këto masa janë jetike për të ndaluar shpopullimin masiv që po përjeton vendi vitet e fundit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”*, paraqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar arsimin si prioritet kombëtar dhe me bindjen e plotë se vetëm investimi në edukim mund të frenojë largimin e të rinjve, pedagogëve dhe intelektualëve nga vendi, gjithashtu duke adresuar mbajtjen e premtimeve elektorale të qeverisë për ta çuar buxhetin e arsimit në 5% PPB, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

**DEPUTETI:**

ERISA XHIXHO 

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

## **ANEKSI 1**

Në projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2023” të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në nenin 1, “Për Buxhetin e vitit 2023”, në tabelën nr.1 të buxhetit, në kodin 11/09450 “arsimi i lartë”, të shtohet vlera 1.47 miliard lekë dhe në kodin 11/09770, të shtohet vlera **5 miliardë lekë**, me qëllim rritjen e granteve në mësimdhënie dhe në kërkime shkencore në arsimin e lartë.

Seancës Pleurore  
22/11/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:**

**MBULIMI I KOSTOS SË LIBRAVE NGA KLASA E PARË DERI NË TË NËNTËN, NË TABELËN NR. 1 TË BUXHETIT NË KODIN 11/09120 "ARSIMI BAZË", ARTIKULLI 606.**

**KËRKUES:**

**Znj. Erisa Xhixho**

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:**

**"PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN PËR BUXHETIN E VITIT 2023"**

**BAZA LIGJORE:**

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Nxënësit e klasës I deri IX dhe prindërit e tyre u përballën edhe këtë vit shkollor me një shqetësim për librat falas që jepen çdo vit në shkollat shqiptare. Edhe pse jepen falas, këta libra janë të përdorur dhe jashtë funksionit për nxënësit që i marrin në përdorim, çka bën që prindërit të detyrohen t'i blejnë në rastin më të mirë, duke shtuar koston në këto kohë të vështira ekonomike për familjet shqiptare për shkak të krizës së çmimeve.

Në vazhdimësi është kërkuar që premtimi i qeverisë për libra falas të realizohet plotësisht duke ofruar çdo vit libra të rinj falas për nxënësit.

Prindërit përballen sot me kosto shumë të larta, ndaj me qëllimin për të mbështetur arsimin cilësor, duke ndihmuar nxënësit të kenë të gjithë libra të rinj çdo vit shkollor, propozoj 350 milionë lekë shtesë që të ribotohen të gjitha librat nga klasa I deri në klasën IX. Ndryshimi duhet bërë në tabelën I, grupi II, programi 09120 "Arsimi bazë", artikulli 606.




**PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”,* paraqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar arsimin si prioritet kombëtar dhe me bindjen e plotë se vetëm investimi në edukim mund të frenojë largimin e të rinjve dhe prindërve të tyre nga vendi, gjithashtu duke adresuar mbajtjen e premtimeve elektorale të qeverisë për ta çuar buxhetin e arsimit në 5 % të PPB-së, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

**DEPUTETI:**

ERISA XHIXHO 

(emër, mbiemër, nënshkrimi)



## **ANEKSI 1**

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2023 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në nenin 1, “Për buxhetin e vitit 2023”, në tabelën nr. 1, të buxhetit, në kodin 11/09120 “arsimi bazë” artikulli 606, me qëllim bulimi i kostos së librave nga klasa e parë deri në të nëntën, të shtohet vlera 350 milionë lekë,

*Sevdin Plenari*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

## AMENDAMENT

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Z. Bujar Leskaj propozon,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Neni 10, paragrafi i parafundit, riformulohet me përmbajtje si vijon:

“Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, qeveria të përcaktojë Minimumin Jetik Zyrtar, në bazë të studimeve dhe anketave të deritanishme, të kryera nga Instituti i Statistikave. Duke filluar nga korriku 2023, gjatë gjithë gjashtëmujorit të dytë dhe për buxhetet e viteve në vijim, pagesat për personat me aftësi të kufizuar dhe për familjet në skemën e asistencës sociale të indeksohen (plotësohen), deri në respektimin e Minimumit Jetik Zyrtar”.

#### Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset e ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"

Nga analiza e legjislacionit shqiptar në tërësi, rezulton se minimumi jetik është një normë ligjore që buron nga të drejtat kushtetuese të qytetarëve. Edhe pse koncepti i minimumit jetik është i parashikuar prej më tepër se 2 dekadash si një normë kufizuese për mbrojtjen e burimit të të ardhurave, kryesisht të punëmarrësve, mungojnë aktet ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë masën e minimumit jetik zyrtar dhe përshtatjen e kësaj mase në planin kohor.


Kjo mangësi ka nxitur zbatimin e standardeve të dyfishta në mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve, në lidhje me garancitë që duhet të ofrojë legjislacioni, përsa i përket minimumit jetik.

Mungesa e përkufizimit të minimumit jetik zyrtar në legjislacionin për mbrojtjen sociale, ndikon negativisht në hartimin e politikave të përshtatshme për mbrojtjen sociale, sidomos në përcaktimin e qartë të qëllimit të tyre.

Ky amendament synon marrjen e një angazhimi serioz të përvitshëm, në mënyrë që vakumi normativ i përcaktimit të minimumit jetik zyrtar të përfundojë sa më parë dhe të vendoset një standard normativ me efekte të drejtpërdrejta në politikat sociale dhe ekonomike, si dhe të sigurohen garancitë e qytetarëve, në drejtim të sigurimit të mjeteve të tyre të jetesës.

Minimumi Jetik Zyrtar do të t'u sigurojë personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve në skemë e ndihmës sociale një jetesë dinjitoze me shërbimet bazike, si dhe do t'u mundësojë të gjithë shtetasve që të marrin pjesë aktive në shoqëri, pavarësisht nga aftësia e tyre për të punuar.

**Bujar LESKAJ**



*Scorës Revue*  
*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

AMENDAMENT



**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetet Znj. Orjola Pampuri dhe Znj. Zheni Gjergji propozon,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në Tabelën 4 “Treguesit fiskal (t-2 deri t+2) 2023” bashkëlidhur, në emërimin “Totali i Shpenzimeve”, zëri 7 “Shpenzime të tjera” - “Ndihma ekonomike dhe paaftësia”, në kolonën “Buxheti 2023”, vlera “25 950” të zëvendësohet me vlerën “30 000”.

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.



## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### **PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

Duke marrë si referim shpenzimet mesatare mujore të njësisve ekonomike familjare për vitin 2021, të dhëna INSTAT, si vit bazë me vlerën prej 84,548 ALL e ndarë në 12 kategoritë e shpenzimeve të familjeve shqiptare dhe peshën specifike mesatare që ato zënë (shih tabela 1) për vitin 2021, shihet se kategoria “ushqim dhe pije jo alkolike” zë më shumë se 2/5 e shpenzimeve ose 41.3% duke vijuar me shpenzime për banesë, ujë dhe energji elektrike me 10% e kështu me rradhë. Nga ana tjetër po të krahasojmë nivelin e rritjeve së cmimeve për secilën prej këtyre 12 kategorive për muajin Tetor 2022 sipas Indeksit të Cmimeve të Konsumit të INSTAT (tabela 2) ku rritja më e madhe dominohet nga “ushqime dhe pije joalkolike” me 19.8% më shumë dhe transport me 25% më shumë. Ndaj për të vlerësuar nivelin aktual të ndikimit në buxhetet familjare të shqiptarëve, mjafton të përlogaritet për secilën kategori të shpenzimeve sipas të dhënave Tetor 2022, niveli i rritjes së cmimeve mesatar i ponderuar është në masën 12.21% deri në tetor 2022 krahasuar me vitin 2021 (tabela 3). Pra mesatarisht familjet shqiptare shpenzojnë së paku 12.21% më shumë krahasuar se një vit më parë si pasojë e efektit të rritjes së cmimeve.

Poashtu nisur nga fakti që qeveria shqiptare ende sot nuk bërë një përlogaritje se sa është niveli i minimumit jetik në Shqipëri, edhe pse vlerësime të ndryshme të pavaruara bëjnë një vlerësim që shkon përtej nivelit e të ardhurave disa herë më të lartë se përfitimi i ndihmës ekonomike. Poashtu duke marrë parasysh se niveli i varfërisë relative në Shqipëri për vitin 2020 ishte në nivelin 35% pra varfëria relative sipas vlerësimit ndërkombëtar 5.5 USD/për frymë/në ditë, dukshëm dhe ky nivel është më i lartë disa herë se të ardhurat të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe nëse do të marrim parasysh efektet e krizës së ndikuar nga rritja e cmimeve që vetëm sipas një vlerësimi të UNCEF, deri në mes të këtij viti 12 mijë fëmijë shqiptarë dhe 40 mijë shqiptarë janë futur për herë të parë nën minimumin jetik, varfëria relative po i afrohet nivelit të njëjtë të vitit 2005 me 40% të popullsisë, 2.5 herë më i lartë se mesatarja e rajonit dhe 7 herë më i lartë se mesatarja e vendeve të BE.

Në këtë kontekst duke marrë parasysh këtë luhajtje të rritjes së cmimeve të konsumit të familjeve mesatare shqiptare, edhe pse duhet pranuar fakti që familjet me të ardhura të ulta kryesisht ata nën mbrojtjen sociale, që trajtohen me ndihmë ekonomike, i zë kategoria e shpenzimeve “ushqime dhe pije jo alkolike” të cilat deri më tetor 2022 kanë patur një rritje mestare prej 20%.



Prandaj, ne kemi propozuar dyfishimin e ndihmës ekonomike për 65 mijë familje përfituese, duke rialokuar një fond prej 4 miliardë lekësh. Ky fond të sigurohet nga fondi i rialokuar nga shpenzimet operative të qeverisjes qendrore dhe PPP-të, me mbështetje buxhetore.

**Orjola PAMPURI**



**Zheni GJERGJI**



*Levica Plena*  
*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**KUVENDI**  
NR 3948 DATE 22.11.22

AMENDAMENT

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Z. Helidon Bushati dhe Z. Bujar Leskaj propozojnë,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në Tabelën 4 “Treguesit fiskal (t-2 deri t+2) 2023” bashkëlidhur, në emërimin “Totali i Shpenzimeve”, zëri 7 “Shpenzime të tjera” - “Kompensim për ish të përndjekurit politikë”, në kolonën “Buxheti 2023”, vlera “1,000” të zëvendësohet me vlerën “3,000”.

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset e ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”


Amendamenti synon që nëpërmjet 3-fishimit të fondeve të akorduara nga qeveria shqiptare për dëmshpërblimin e të ish-përndjekurve politikë t’u japë mundësi këtyre personave, por edhe familjarëve të tyre, që të përfitojnë në një kohë sa më të shkurtër shpërblimet që iu takojnë. Kjo jo vetëm si një detyrim i qartë ligjor, por edhe në funksion të drejtësisë dhe paqes sociale.

Nga ana tjetër, nëpërmjet një politike që synon rritjen e financimit buxhetor me do të bëhet e mundur që brenda 10 viteve të ardhshme qeveria shqiptare të përmbyllë plotësisht detyrimet e saj financiare ndaj përfituesve të kësaj shtrese, të cilët prej nëntë vitesh përballen me zvarritje dhe premtime të mbajtura nga qeveria socialiste.

KLSH në raportin e saj të fundit për zbatimin e buxhetit të shtetit 2021, ka konstatuar se detyrimet financiare ende të papaguara të qeverisë ndaj kësaj shtrese arrijnë në vlerën mbi 30 miliardë lekë. Duke marrë në konsideratë faktin që qeveria planifikon në buxhetin e vitit 2023 dhe PBA për vitet e ardhshme një fond vjetor prej vetëm 1 miliardë lekë, arrijmë lehtësisht në konkluzionin se me këtë ritëm financimi do të duhen plot tre dekada për të përmbyllur detyrimin financiar ndaj shtresës së ish të përndjekurve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre.

Për këtë arsye, lind nevoja e rishikimit në rritje të financimit buxhetor vjetor. Nisur nga përgjegjshmëria politike dhe morale e gërshetuar edhe me mundësitë financiare të buxhetit të shtetit, propozojmë të paktën 3-fishimin e vlerës së propozuar nga qeveria për dëmshpërblimin e shtresës së ish të përndjekurve për vitin 2023, nga 1 miliardë lekë që propozohet nga qeveria në projektbuxhet, në 3 miliardë lekë. Ky fond mund të rialokohet lehtësisht nga fondi i shpenzimeve të qeverisjes qendrore, pa cënuar nivelet e planifikuara të deficitit buxhetor.

**Helidon BUSHATI**



**Bujar LESKAJ**



*Severin Rencore*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

## AMENDAMENT

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Z. Bujar Leskaj propozon,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2023", të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Neni 10, paragrafi i fundit riformulohet me përmbajtje si vijon:

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2023, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme, 20 për qind për financimin e skemës së dëshmpërblimit të ish të përndjekurve politikë dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me të njëjtën masë kufirin e deficit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

#### Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset e ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"

Ky amendament synon marrjen e një angazhimi serioz të përvitshëm për rritjen e financimit për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë. Sipas raportit të KLSH për zbatimin të buxhetit të shtetit 2021, detyrimet aktuale ndaj shtresës së përndjekurve përlllogaritën në vlerën rreth 30 miliardë lekë, cka do të thotë se shtetit shqiptar i duhen rreth tre dekada për të mbyllur përbushur detyrimet ndaj të përndjekurve.

Me qëllim që ky detyrim të realizohet në një afat më të shkurtër dhe subjektet e prekura të dëmshpërblehen në një kohë më të përshtatshme, përveç fondit të dedikuar, propozoj që nëpërmjet këtij amendamenti 20 për qind e të ardhurave nga privatizimet që do të realizohen gjatë vitit 2023, të shkojnë për financimin e kësaj skeme.

**Bujar LESKAJ**





*Seerat Plenare*  
*Z. Oerd*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

## AMENDAMENT

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Z. Oerd Bylykbashi, në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, propozon të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Në nenin 14, paragrafi:

*"Fondi rezervë prej 3 600 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave si më poshtë:*

- a) 1 800 milionë lekë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithëshme;*
- b) 1 800 milionë lekë për përballimin e kostos së zgjedhjeve..”,*

zëvendsohet me paragrafin me këtë përmbajtje:

*"Fondi rezervë prej 4 530 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave si më poshtë:*

- a) 1 800 milionë lekë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithëshme;*
- b) 1 800 milionë lekë për përballimin e kostos së zgjedhjeve.”;*
- c) 930 milion lekë për përballimin e kostos për votimin dhe numërimin elektronik në bashkinë Durrës dhe bashkinë Elbasan.*

#### Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Marrëveshja e 5 qershorit 2020 për reformën zgjedhore kishte si kusht kryesor për dakordësi realizimin e votimit dhe numërimit elektronik, duke filluar me projekte pilot të realizuar nga KQZ. Votimi dhe numërimi elektronik është realizuar me sukses të plotë në dy faza pilot të njëpasnjëshme; faza e parë është realizuar në KZAZ që mbulon Njësinë administrative no. 10 të bashkisë Tiranë në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021, ndërsa faza e dytë pilot u zbatua në bashkinë Vorë në zgjedhjet e pjesëshme të 6 marsit 2022.

Shtirja e deritanishme nuk është në përputhje me kërkesën e Kodit Zgjedhor. Kodi Zgjedhor obligon shtirjen graduale me rritje jo më pak se 10% të numrit të zgjedhësve, nga një process zgjedhor në tjetrin. Kodi Zgjedhor detyron rritjen e shtirjes së teknologjisë në votim në varësi të suksesit në fazat paraprake. **Suksesi i plotë në dy fazat e para pilot ka qenë i plotë duke siguruar nxjerrjen e plotë të rezultatit brenda një ore pas mbylljes së votimit.** Kjo bëri të mundur privatësinë e votimit, sigurinë dhe shpejtësinë e rezultatit, transparencën dhe depolitizimin e plotë të numërimit, uljen drastike të votave të pavlefshme, eliminimin e ankimeve, eliminimin e logjistikës dhe kostove të tjera organizative, materiale dhe financiare të fletëve të votimit dhe numërimit.

Një proces votimi dhe numërimi i shpejtë dhe i sigurt ul jo vetëm kostot dhe kohën e procesit zgjedhor por edhe rrit sigurinë e procesit politik me ndikim në uljen e humbjeve të larta në sistemin fiskal dhe doganor të vendit që shoqërojnë tipikisht proceset e pasigurta dhe të zgjatura zgjedhore për shkak të evazionit, shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit, si dhe kostot që përballojnë subjektet zgjedhore, kosto apo humbje këto që nuk përlllogariten në kostot buxhetore të procesit zgjedhor.

Ky amendament parashikon që veç bashkisë së Vorës, votim/numërimi të shtrihet në bashkitë e Durrësit dhe Elbasanit, që të dyja se bashku përbëjnë rreth 11% të qendrave të votimit në shkallë vendi. KQZ ka vlerësuar dhe kërkuar që për shtirjen e të votimit dhe numërimit elektronik në këto bashki nevojiten rreth 930 milion lekë ose rreth 7,95 milion Euro (shih tabelën më poshtë). Duhet theksuar që pajisjet shërbejnë për të paktën pesë palë zgjedhje, pra kostoja e votimit dhe numërimit elektronik në këto bashki për një palë zgjedhje është rreth 186 milionë lekë ose 1,59 milion Euro. Aktualisht shpenzohen rreth 2,5 milion (apo rreth 500 Euro për qendër votimi) për kuti votimi, logjistikë dhe kosto transporti, logjistikë dhe materiale të qendrave të numërimit, komisionerë dhe numërues, kostomirë mbajtjeje dhe ruajtje e sigurie nga policia e shtetit, etj. Në zgjerimin e projektit sipas këtij propozimi, do të kurseheshin rreth 280 mijë Euro për një palë zgjedhje, ose rreth 1,4 milion Euro në pesë palë zgjedhje, cikël ky vlerësuar për përdorimin e pajisjeve.

Bashkia	Nr. QV	Nr. pajisjeve	Total ALL/Bashki	Total Euro/Bashki
Bashkia Durrs	335	704	558,395,064.27	4,772,607.39
Bashkia Elbasan	222	467	370,412,634.96	3,165,919.96
			<b>928,807,699.23</b>	<b>7,938,527.34</b>

Prandaj, me qëllim përballimin e faturës financiare për realizimin e infrastrukturës së nevojshme për realizimin e procesit të votimit dhe numërimit elektronik për bashkitë Durrës dhe Elbasan në zgjedhjet vendore të 14 maj 2023, ne propozojmë alokimin e një fondi prej 930 milionë lekë në buxhetin e vitit 2023.

Ky fond shtesë prej 930 milion lekësh mund të sigurohet nga rialokimi i fondeve të parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qendrore, projekteve për rikonstruksione zyresh dhe mobilime, dhe PPP-t me mbështetje buxhetore, pa cënuar nivelet e parashikuara të defiçitit vjetor buxhetor.

**Oerd BYLYKBASHI**

Peçani Revue



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



AMENDAMENT

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti  
Z. Sali Berisha,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 11, fjalia "Fondi prej 2 300 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave", zëvendësohet me fjalinë:

*Fondi prej 23 000 milionë lekësh do të përdoret për politika të reja rritje pagash për të gjithë punonjësit e administratës publike, me të paktën 25%, duke filluar nga 1 Janari 2023, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.



# **RELACION**

## **PËR AMENDAMENTIN**

### **PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

Gjendja ekonomike familjare dhe fuqia blerëse e 84.500 punonjësve të administratës publike, ku përfshihen edhe mësuesit, pedagogët, mjekët, infermierët, policët, ushtarakët, etj, është rënduar ndjeshëm sidomos vitin e fundit si pasojë e rritjes dyshifrore të çmimeve të shportës së konsumit.


Rritja e përgjithshme e çmimeve, ka sjellë një zhvlerësim të pagës së tyre, duke cënuar deri në pamundësi për të siguruar të ardhura të mjaftueshme për të përballuar një jetesë dinjitoze.

84.500 punonjësit të administratës publike janë të nënpaguar dhe të pamotivuar për të kryer misionin e tyre, duke shkaktuar edhe rënie të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Prandaj, me qëllim rritjen e pagave me të paktën 25% për të gjithë 84.500 punonjësit e administratës publike duke filluar nga 1 janari 2023, ne propozojmë një rritje të fondit të dedikuar nga 2.3 miliardë lekë që parashikohet aktualisht në projektbuxhetin 2023 në masën 23 miliardë lekë.

Kjo rritje e fondit të dedikuar për rritjen e pagave mund të sigurohet nga rialokimi i fondeve të parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qendrore, projekteve për rikonstruksione zyresh dhe mobilime, dhe PPP-të me mbështetje buxhetore, pa cënuar nivelet e parashikuara të deficitit vjetor buxhetor.

**SALI BERISHA**





*Francis Ruzic*  
*[Signature]*

**KUVENDI**  
NR 3958 DATE 23.11.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KUVENDI**

## AMENDAMENT

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Znj. Albana Vokshi,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2023", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Në nenin 18, shtohet pas paragrafit të parë, paragrafi i dytë me përmbajtje si vijon:

Gjatë vitit 2023, nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk do të financohet asnjë prej kontratave të mëposhtme koncesionare në sektorin shëndetësor:

"Koncesioni/PPP Kontrolli bazë i popullsisë 35-70 vjec (check-up)".

"Koncesioni/PPP Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale".

"Koncesioni/PPP Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore".

#### Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"

Koncesionet PPP me financim buxhetor në sektorin shëndetësor kanë rezultuar me shkelje të shumta ligjore, të cilat janë aktualisht nën hetim për korrupsion dhe shpërdorim detyre nga Struktura e Posacme Anti-Korrupsion.

Në këtë kuptim, qeveria shqiptare nuk mund të vazhdojë të përdorë paratë e taksapaguesve shqiptarë për të financuar afëra korruptive, sic janë ato të koncesioneve në shëndetësi.

Prandaj, me qëllim ndalimin e shpërdorimit dhe vjedhjes së parave publike, propozojmë që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2023 të mos alokojë asnjë fond për financimin e tre kontratave koncesionare në shëndetësi, të lidhura pas vitit 2013.

**Albana VOKSHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

AMENDAMENT



**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti  
Z. Edmond Spaho,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në fund të nenin 11, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

*Fondi prej 5 miliardë lekë për kompensimin e bizneseve ndaj humbjeve/dëmeve të shkaktuara nga kufizimet dhe pasojat në ekonomi të shkaktuara nga Covid-19, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.*

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

# RELACION

## PËR AMENDAMENTIN

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"

Covid-19 dhe pasojat negative qe shkaktoi ne ekonomine shqiptare kane qene mjaft te ndjeshme. Bizneset qe operojne ne vendin tone kane regjistruar humbje te medha si pasoje e kufizimeve ne orare dhe nga ulja e fuqise blerese konsumatore.

Qeveria asokohe shpalli gjendjen e emergjencës kombëtare dhe pavarësisht kërkesës së sipërmarrësve për tu mbështetur financiarisht në proporcion të ngjashëm me sipërmarrësit e vendeve fqinje, rezultoi se qeveria nuk ndërmori paketat e duhura mbështetëse për të ndihmuar bizneset.

Ashtu sic u faktua edhe nga raportet e institucioneve ndërkombëtare, qeveria shqiptare ndërmori paketën mbështetëse më të ulët në rajon.

Prandaj, me qëllim vendosjen në vend të së drejtes së bizneseve për tu kompensuar nga dëmet/humbjet e shkaktuara nga shpallja e gjendjes së emergjencës kombëtare Covid-19, në propozojmë alokimin e një fondi prej 5 miliardë lekë në buxhetin e vitit 2023 për kompensimin, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.

Ky fond mund të sigurohet nga rialokimi i fondeve të parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qendrore, projekteve për rikonstruksione zyresh dhe mobilime, dhe PPP-të me mbështetje buxhetore.

**Edmond SPAHO**

*Edmond Spaho*  
*Spaho*



Seancës Plevere  
22/11/2022  
[Signature]

**KUVENDI**  
NR 3928 DATE 22.11.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KUVENDI**

## AMENDAMENT

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Znj. Ina Zhupa propozon,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Në nenin 11, pas fjalisë “Fondi prej 2 300 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Fondi prej 1.5miliardë lekësh do të përdoret për rritjen e pagave të të gjithë punonjësve në sektorin e arsimit të lartë, me të paktën 20%, duke filluar nga 1 Janari 2023, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

#### Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

## AMENDAMENT

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Znj. Ina Zhupa propozon,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Në nenin 11, pas fjalisë “Fondi prej 2 300 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Fondi prej 1.5 miliardë lekësh do të përdoret për rritjen e pagave të të gjithë punonjësve në sektorin e arsimit të lartë, me të paktën 30%, duke filluar nga 1 Janari 2023, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

#### Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Protestat e pedagogëve treguan trajtimin aspak dinjitoz që i bëhet trupës akademike të universiteteve publike. Megjithëse, janë të ngarkuar me misionin e lartë të edukimit dhe formimit të brezave të rinj, trajtimi që ata marrin sot është shpeshherë më i ulët se profesione që kërkojnë arsimin dhe kualifikim më të pakët.

Në peticionet dhe kërkesat zyrtare që ata i kanë adresuar institucioneve publike, kanë bërë të qartë se rritja e përgjithshme e cmimeve, e shkaktuar pandemia COVID-19 dhe agresioni rus në Ukrainë, por edhe inflacioni, kanë sjellë një zhvleftësim të pagës së tyre, duke cuar deri në pamundësi për të siguruar të ardhura të mjaftueshme për veten dhe familjen për një jetë dinjitoze.

Në këtë kuptim, pedagogët sot ndihen të keqtrajtuar dhe të pamotivuar për vazhdimin e misionit të tyre, cka ka sjellë që shumë pedagogë të zgjedhin braktisjen e universiteteve publike për punë të tjera apo në raste të tjera edhe braktisjen e vendit. Është detyrimi jonë si ligjvënës, vecanërisht për anëtarët e Komisionit Parlamentar për Arsimin, që t'i përgjigjemi shqetësimeve të drejta të ngritura nga trupa akademike.

Prandaj, ne propozojmë një rritje të fondit të dedikuar për rritjen e pagave të pedagogëve në masën 20% ose në vlerë 1 miliardë lekë. Ky fond mund të sigurohet lehtësisht nga rialokimi i fondeve të dedikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qëndrore dhe PPP-të, me mbështetje buxhetore.

**Ina ZHUPA**



Seances Pleuale  
22/11/2022

**KUVENDI**  
NR 3929 DATE 22.11.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KUVENDI**

**AMENDAMENT**

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Znj. Ina Zhupa propozon,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 16, pas gërmës “c”, me emërimin “granti i punës kërkimore, shkencore dhe veprimtarive krijuese”, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Vlera e alokuar për vitin 2023 do të jetë të paktën 1 000 milionë lekë.*

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.



## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”


Nisur nga shqetësimet e bëra publike nga trupa akademike e universiteteve publike, rezulton se fondi i dedikuar për punën kërkimore, shkencore dhe veprimtaritë krijuese është krejtësisht i pamjaftueshëm për realizimin e kërkimeve të nevojshme shkencore nga ana e personelit të institucioneve të arsimit të lartë. Prej vitesh, universitetet publike vuajnë nga mungesa e mbështetjes financiare për realizimin e projekteve kërkimore, të cilat aktualisht përballohen nga vetë stafet akademike.

Me qëllim që universitetet publike dhe stafet e tyre të mbështeten mjaftueshëm me fonde për realizimin e projekteve kërkimore shkencore, propozojmë që granti i dedikuar të jetë të paktën 1 miliardë lekë. Efekti shtesë prej 700 milionë lekësh do të përballohet nga ulja e shpenzimeve operative të qeverisjes qendrore dhe PPP-të, me mbështetje buxhetore. Shqipëria sot ka më shumë nevojë për punën kërkimore shkencore se sa zyra luksi, udhëtime, karburant, chartera etj.

**Ina ZHUPA**



Seancën Plenare  
22/11/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**KUVENDI**  
NR 3922 DATE 22.11.22

AMENDAMENTE

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetët Znj. Dhurata Çupi dhe Z. Arbi Agalliu,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 4, pika 2, fjalia “Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 1.200 milionë lekë”, të ndryshohet si më poshtë vijon:

*Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 12.000 milionë lekë.*

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Situata e pandemisë COVID-19 dhe më pas agresioni rus në Ukrainë kanë provokuar një rritje të vazhdueshme të çmimeve të produkteve të konsumit. Vetëm në muajin Tetor 2022, sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it, shporta e ushqimeve është rritur me të paktën 14.6%. Ndërkohë, që të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që në praktikë çmimet janë rritur edhe më shumë nga ajo që raportohet nga INSTAT-i.

Ndërkohë, që çmimet rriten në mënyrë të pakontrolluar, qeveria nuk ka ndërmarrë paketa mbështetëse serioze ndaj shtesave në nevojë, përfshirë pensionistët. Vitin e ardhshëm, qeveria ka parashikuar rritjen e pensioneve me vetëm 1% duke filluar nga 1 Janari 2023. Një rritje krejtësisht e pamjaftueshme për të përballuar rritjen e kostove të jetesës për një ndër shtresat më vulnerabël, siç janë pensionistët.

Prandaj, ne propozojmë një rritje të pensioneve prej të paktën 10% për vitin 2023, me efekt nga 1 Janari 2023 e në vijim. Për këtë nevojitet një fond prej të paktën 12 miliardë lekësh, të cilat janë lehtësisht të rialokueshme nga fondet të dedikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qendrore (udhëtime, dieta, hotele, karburant, çarter etj.), dhe PPP-të, pa cënuar nivelet e defiçit të planifikuar vjetor.

**Dhurata ÇUPI**



**Arbi AGALLIU**

ARBI AGALLIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

AMENDAMENT

KUVENDI

NR. 3962 DATE 23.11.22

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti  
Znj. Greta Bardeli,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 11, pas fjalisë: Fondi prej 12 000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat

Shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

*Fondi prej 2 miliardë lekë për mbështetjen e sektorit energjetik përdoret për të përballuar kostot e dëmshpërblimit të dëmeve të shkaktuara nga përmytjet në qarkun Shkodër dhe Qarkun Lezhë, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.*

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.



## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### **PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

Situata e permbytjeve ka filluar ne mengjesin e dates 20.11.2022. Kjo situatë ka filluar nga hapja e portave dhe shkarkimi i pakontrolluar i ujrave te hidrocentralit Vau i Dejes. Kjo mund te verifikohet lehtesisht pasi te gjitha banesat dhe siperfaqet te mbuluara nga uji ndodhen ne afersi te brigjeve te Drinit i cili duke u fryer tej mase, per shkak te shkarkimeve, permbyti zonat Berdice e Siperme, Kuc, Lagjet e qytetit Ajasem dhe Bahcallek.

Gjate dites se djeshme, date 22.11.2022, me reduktimin e shkarkimeve uji nga zonat e mesiperme eshte terhequr. Vlen te theksohet qe reshjet e shiut kane vazhduar.

Rreziku fillestar i shkarkimeve do kishte qene me pasoja shume here me te medhaja por per fat te banoreve te Shkodres kuotat e liqenit te Shkodres kane qene ne nivele jo te larta gje e cila ka bere te mundur zbutjen e pasojave te shkarkimit te asaj dite. Kjo mund te verifikohet lehtesisht me te dhenat e mbledhura me date 20.11.2022 ku pervec kuotave te matura nga specialistet ne terren eshte verejtur ndryshimi i kahut te rrjedhjes se lumit Buna ne drejtim te liqenit. Nje fakt per t'u marre ne konsiderat mbi furine e shkarkimeve te ujrave nga hidrocentrali eshte dhe demtimi i ures se vjeter te Bahcallekut gje e cila ska ndodhur ne permbytjet e 2010.

Per sa i perket zones se Nen Shkodres, pastrami i kanaleve kulluese te tre niveleve eshte kryer ne masen mbi 70%. Kjo ka bere te mundur qe siperfaqet e tokave ne disa fshatra te kesaj zone te evadohen mjagft mire. Me gjithë pastrimin e kanaleve nje ndikim te madh ne largimin e ujrave nga toka bujqesore kane hidrovoret te cilet, sidomos ai i Casit, ditën e pare te permbytjes ka qene ne funksion me kapacitet minimal.

Pasojat e permbytjes pervec veshtiresive krijuar banoreve kane sjelle deme te konsiderueshme ne banesa, biznese, baze materiale, toka bujqesore dhe baze ushqimore per blegtorine. Permbytjet e vazhdueshme ne territorin e Shkodres kane dekurajuar fermeret e ketyre zonave per zhvillimin e Bujqesise me pasoje jo vetem renien e prodhimit bujqesor por dhe influencuar ne largimin e banoreve per te gjetur mundesi te tjera jetese si brenda vendin ashtu dhe jashte. Qe nga permbytjet e vitit 2010 banoret nuk jane demshperblyer per demet e shkaktuara.

Nga ana e Bashkise Shkodër, në kuadër të thirrjes për aplikim për projekte për “Fonde për Menaxhimin e Fatkeqsive Natyrore” të programit “Për Emergjencat Civile 2022” shpallur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ka aplikuar me projektin “Reduktimi i Pasojave të Përmbytjes në Zonën e Nën-Shkodrës”.

Ky projekt synonte parandalimin dhe reduktimin e pasojave të përmbytjeve në zonat e Nën Shkodrës: Velipojë, Dajç, Bërdicë, Ana e Malit, Guri i Zi dhe Rrethina. Projekti parashikonte ndërhyrje rehabilituese ne veprat e artit (Ura dhe Tombino), kanalet dytësore dhe tretësore si dhe mjete për rastet e emergjencave civile në zona urbane dhe rurale.

Vlera e këtij projekti në total ishte **88,261,000 leke**. Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile është njoftuar që projekti i aplikuar nga Bashkia Shkodër nuk kualifikohet si projekt fitues.

Ndërkohë bashkia Shkodër ka kërkuar informacionin për aplikimin dhe vlerësimin e projektit Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile duke kërkuar informacion rreth:

- Listës së projekteve të shpallura fituese dhe kriterëve përkatëse të vlerësimit
- Vlerësimit të projektit të Bashkisë Shkodër sipas vendimit nr. 7 datë 13.7.2022 të Komitetit të Menaxhimit të Fatkeqsive Natyrore (Vendim i cili nuk është bërë publik)
- Problematikat që mund të ketë pasur ky projekt
- Nga ana e kesaj Agjencie ky informacion nuk është bere disponibel.

**Mendojme se ky projekt ne qofte se do merrej parasysh do të kishte një ndikim tejet të veçantë në zonën e Nën Shkodrës duke impaktuar direkt një popullsi prej 75,000 banorësh si dhe në infrastrukturën publike.**

**Vlera e ketij projekti prej rreth 90 milion lekesh te jete pjese e amendamentit per disa ndryshime per buxhetin e vitit 2023.**

Prandaj, me qëllim përballimin e faturës financiare për dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e papritur, si pasoje e hapjes se portave shkarkuese, ne propozojme alokimin e një fondi prej 2 miliardë lekë në buxhetin e vitit 2023.

Ky fond mund të sigurohet nga rialokimi i fondeve të parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qendrore, projekteve për rikonstruksione zyresh dhe mobilime, dhe PPP-të me mbështetje buxhetore.

**Greta BARDELI**

*George Ruzha*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

## AMENDAMENTE

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Lindita Metaliaj,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Në tabelën 1 “Buxheti 2023 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore”, në rreshtin 13 “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, kolonën “Totali i shpenzimeve buxhetore”, vlera “78.045.728 mijë lekë” zëvendësohet me “99.800.000 mijë lekë”.

#### Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.



## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Me qëllim rritjen e financimit të sektorit shëndetësor, i cili ndër vite ka qenë i nënfinancuar krahasuar me nevojat reale dhe gjithashtu me qëllim rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore, rritjen e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar, rritjen e investime në infrastrukturën spitalore dhe qendrat shëndetësore, rritjen e pagave për mjekët, infermierët dhe stafet ndihmëse, propozojmë rritjen me 1% të GDP-së për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Efektet financiare në Buxhetin e Shtetit do të përballohen nga ulja në të njëjtën masë të shpenzimeve operative qeveritare dhe kontratave koncesionare/PPP.

Lindita METALIAJ





*Seancën Plenore*  
*[Signature]*

**KUVENDI**  
NR 3961 DATE 23.11.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KUVENDI**

**AMENDAMENTE**

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Z. Luciano Boci,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në tabelën 1 “Buxheti 2023 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore”, në rreshtin 11 “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, kolonën “Totali i shpenzimeve buxhetore”, vlera “47.174.000 mijë lekë” zëvendësohet me “108.000.000 mijë lekë”.

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"

Me qëllim rritjen e financimit të sektorit arsimor, i cili ndër vite ka qenë i nënfinancuar krahasuar me nevojat reale dhe gjithashtu me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe universitar, rritjen e investimeve në infrastrukturë shkollore, rritjen e pagave të mësuesve dhe pedagogëve, financimin e bonusit të studentëve për të përballuar efektet e rritjes së cmimeve të muajve të fundit etj., propozojmë rritjen e buxhetit deri në masën 5% të GDP-së për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Efektet financiare në Buxhetin e Shtetit do të përballohen nga ulja në të njëjtën masë të shpenzimeve operative qeveritare, investimeve jo-prioritare për rikonstrukcione zyrash dhe mobilime dhe kontratave koncesionare/PPP.

**Luciano BOCI**

*LUCIANO BOCI*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

AMENDAMENT

KUVENDI

NR 3911 DATE 21.11.22

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2023”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja *Znj.*  
Eralda Bano propozon,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në Tabelën Nr. 2 “Numri i punonjësve 2023 sipas institucioneve”, zëri “Ministria e  
Arsimit dhe Sportit”, numri “31.005” zëvendësohet me “numri 31.105”.

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN

#### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Ky amandament vjen si një nevojë e domosdoshme për rritjen e numrit të mësuesve ndihmës, ndërkohë që për fat të keq kemi një rritje të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me aftësi e nevoja ndryshe. Për t’iu përgjigjur këtyre nevojave gjithnjë e në rritje për mësues ndihmës, amendamenti kërkon që të bëjë reale qasjen e edukimit gjithëpërfshirës dhe integritit të fëmijëve me aftësi dhe nevoja ndryshe në insitucionet e arsimit parauniversitar prej edukimit parashkollor deri në arsimin e mesëm e të lartë. Mësuesit ndihmës, në ndryshim nga mësuesit e klasës duhet të jenë të vëmendshëm në detaje të procesit, si dhe të jenë në gjendje të identifikojnë pikat e forta të fëmijëve të cilat duhet ti zhvillojnë. Nisur nga kjo nevojë mësuesi ndihmës duhet të jetë për jo më shumë se dy nxënës me aftësi të kufizur/nevoja ndryshe, ndërkaq që raportimet e mediave vënë theksin se në zona urbane dhe akoma më shumë në zona rurale ka një muangësi të mësuesve ndihmës, për të mos folur pastaj për trajnimin e tyre, ku një pjesë jo e vogël janë pa arsim përkatës dhe e kryejnë atë detyrë sa për të mos humbur vendin e punës. Të dhënat e një studimi të UNICEF, të vitit 2018, tregojnë se: “Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk janë të kënaqur me ecurinë e fëmijës në shkollë (19,4%), me nivelin e përshtatjes së mësimdhënies me nevojat dhe zhvillimin e fëmijës (13,3%) dhe me nivelin e respektit të shfaqur nga stafi arsimor (6,3%)”. Një pjesë e këtyre prindërve kanë ankesa për mungesën e mësuesve ndihmës, largimin e mësuesve ndihmës në vijim të vitit shkollor dhe mos zëvendësimi i tij etj. Nisur edhe nga ky shqetësim legjitim i prindërve është e domosdoshme të rrisim numrin e mësuesve ndihmës, pa harruar edhe shkaqet psiko-sociale të krijuar në vitet e fundit. Si në të gjithë botën ne vijmë pas një periudhe izolimi apo distancimi social, ku kategoria që e vuajti më shumë padyshim kanë qenë fëmijët me aftësi dhe nevoja ndryshe. Për arsye ekonomike e sociale, ata humbën komunikimin me mësuesit e tyre, ky komunikim edhe në rastet që bëhej sillte problematika, pra me pak fjalë u ndërpre procesi i socializimit të tyre. Me kthimin në shkollë, një pjesë e nxënësve nuk gjetën më mësuesit e tyre. Kjo është edhe një arsye tjetër përse kërkohet rritja e numri të mësuesve ndihmës. Ne ligjvënësit që kemi për detyrë, mes të tjerash, të përmirësojmë përmes nismave ligjore dhe qasjeve tona proaktive jetën e shoqërisë për kategori të ndryshme dhe aq më i madh bëhet ky detyrim i yni për



- 1
4. fëmijët me aftësi dhe nevoja ndryshe. Ky amandament veç të tjerash kërkon që të bëjmë realitet detyrimin kuhstetues, që çdo fëmije me aftësitë kufizuar dhe vështirësi në të nxënë ka të drejtë të përfitoj arsim cilësor, ka nevojë për një vëmendje të veçantë dhe për punë të specializuar dhe të mirë organizuar. Çelësi i këtij sukseesi është gjithëpërfshirja përmes një pune të specializuar të mëseve ndihmës ndaj kësaj kategorie nxënësish. Përfitimet e angazhimit të mësuesve ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës, janë të gjera dhe ndikojnë në mënyrë pozitive në arritjen dhe suksesin afatgjatë të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja ndryshe. Marrja e vendimeve te suksesshme për çdo fëmijë, por veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja ndryshe, kërkon që nxënësit ti kushtohet vëmendja e duhur dhe të ketë ndihmën e pakursyer, të specializuar, me humanizëm e përkushtim të mësuesit ndihmës. Shkolla dhe mësuesit gjithmonë duhet t'i mbajnë të përfshirë në jetën shkollore por edhe atë jashtë shkolle të këtyre fëmijëve me qëllimin që të kemi një integrim sa më të mirë, e të plotë në shoqëri. Për këto aryse ne mendojmë se do të ishte i nevojshëm ky amendim, duke dhënë edhe një sinjal pozotitiv, se ne jemi së bashku me prindërit e këtyre fëmijëve, që ata të mos e ndiejnë veten të veçuar dhe pa mundësi reale për të marrë një arsimim cilësor, pavarësisht vendit ku jetojnë apo statusit të tyre social-ekonomik.

*Enxhela Barro*

*Enxhela Barro*

### Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2023 është:

Të ardhurat nga të cilat:	65 584 milionë lekë,
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	21 761 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	9 890 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	33 933 milionë lekë;
Shpenzimet	65 584 milionë lekë.

### Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2023 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat gjithsej nga të cilat:	159 912 milionë lekë,
- kontributet	107 233 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	48 049 milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	1 100 milionë lekë;
- bonusi i pensionistëve	3 530 milionë lekë;
Shpenzimet	159 912 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2022, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar.

Të ardhurat gjithsej nga të cilat:	7 403 milionë lekë,
- kontributet	2 190 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 113 milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	100 milionë lekë;

Shpenzimet

7 403 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 1 200 milionë lekë.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 3 450 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

### **Neni 5**

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2023 është:

Të ardhurat gjithsej	54 536 milionë lekë,
nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	17 077 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	37 459 milionë lekë;
Shpenzimet	54 536 milionë lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 400 milionë lekësh. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 6**

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2023 është:

Të ardhurat gjithsej	4 500 milionë lekë,
nga të cilat:	
- të ardhura të tjera	1 000 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	3 500 milionë lekë;
Shpenzimet	4 500 milionë lekë.

### **Neni 7**

Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 5 000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja. Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në nenet 11 e 15, të këtij ligji.



Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4, të përmendura në nenet 11 e 15, të këtij ligji.

### **Neni 8**

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **KREU II BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT**

### **Neni 9**

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Grantet	20 958	milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	431 200	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	22 900	milionë lekë.

### **Neni 10**

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 25 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë dhe llogarive të fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth 25 353 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikativë, si më poshtë vijon:

- Huamarrje afatgjatë të destinuara për projekte me vlerë rreth 33 660 milionë lekë;
- Emetimi i një Eurobondi me vlerë orientuese prej rreth 59 335 milionë lekësh;
- Huamarrje në formën “mbështetje buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 11 867 milionë lekë;



- Ripagesa të principalit me vlerë rreth (minus) 80 310 milionë lekë të cilat përfshijnë edhe një parablerje të mundshme, të pjesshme, të Eurobondit ekzistues që maturohet në vitin 2025, për një vlerë orientuese prej rreth (minus) 29 668 milionë lekësh;
- Nënhua për pushtetin vendor me vlerë rreth 800 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth (minus) 854 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogaritë e fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë është rreth 6 000 milionë lekë.

Çdo diferencë, që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2023, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.

### **KREU III SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT**

#### **Neni 11**

Shpenzimet e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

- |  |         |               |
|--|---------|---------------|
| - shpenzime të buxhetit qendror            | 519 056 | milionë lekë; |
| - fondi rezervë i buxhetit dhe kontigjenca | 6 600   | milionë lekë; |
| - kontingjencë për risqet e borxhit        | 4 900   | milionë lekë. |

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale është sipas tabelës 1 që i bashkëlidhet këtij ligji. Në tabelat 1/1 dhe 1/2 përcaktohen kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2024 dhe 2025. Transferta e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2023.

Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitet 2023 dhe 2024, me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit, të përcaktuara në shpenzimet korrente të programit buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi prej 12 000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat.

Fondi prej 2 300 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi prej 200 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përdoret për parafinancimin, bashkëfinancimin dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të detyrimeve doganore për projektet me financim të huaj. Procedurat e shpërndarjes së këtij fondi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e shpenzimeve të përcaktuara në nenin 3, si dhe në tabelat 1 dhe 3, që përmenden përkatësisht në nenet 11 dhe 15, të këtij ligji.

## **Neni 12**

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 84 762 veta. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2 në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese ose krijimit të institucioneve të reja.

Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 2, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve/funksioneve të reja.

Këshilli i Ministrave përcakton numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Rregullat për kontraktimin dhe pagesën e punonjësve të përkohshëm përcaktohen në aneksin nr.5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Për vitin 2023 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njërive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përlogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja. Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm

nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogaritur sipas gradave të miratuara.

Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 300 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në tabelën 1, që përmendet në nenin 11, të këtij ligji.

### **Neni 13**

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Metodologjia e llogaritjes së pagës mujore bruto për institucionet e sistemit të drejtësisë miratohet me vendim të Kuvendit.

### **Neni 14**

Fondi rezervë prej 3 600 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

- a) 1 800 milionë lekë për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme;
- b) 1 800 milionë lekë për përballimin e kostos së zgjedhjeve.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 900 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa. Kontingjenca prej 3000 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë, kontingjenca dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.

### **Neni 15**

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme përdoret nga ministria përgjegjëse për financat në përputhje me kriteret e përcaktuara në

aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për programin buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja të transferuara në bashkitë shpërndahet sipas anekseve 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta. Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.

Fondi për emergjencat civile, në masën 800 milionë lekë, akordohet në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me një formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive.

Fondi prej 1 000 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale”, në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave për financimin e projekteve që lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore, sipas kriterëve në aneksin 6 bashkëlidhur këtij ligji.

Fondi prej 200 milionë lekësh, në zërin “Shpenzime kapitale”, në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes përdoret për eliminimin e pasojave në rastet e fatkeqësive natyrore, kur shpenzimi ka natyrën e investimit. Ky fond shpërndahet gjatë vitit buxhetor në bazë të kërkesës së njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas rasteve të ndodhjes së fatkeqësisë.

Fondi për mbetjet urbane në masën 700 milionë lekë akordohet si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbetjet urbane në kolonën “Menaxhimi i mbetjeve” dhe përdoret/shpërndahet në përputhje me kriteret e vendosura në aneksin 7, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë për financim/bashkëfinancim për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe asaj sportive pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sportin. Ministri përgjegjës për arsimin dhe sportin nxjerr udhëzim për kriteret, procedurat, afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## **Neni 16**

Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive:

- a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) granti i mësimdhënies;
- c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.



Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese janë përcaktuar në nenet 111 dhe 113, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë mund të shpërndahet edhe te njësitë e vetëqeverisjes vendore në ato raste kur me vendim të Këshillit të Ministrave ato përcaktohen autoritete kontraktore për realizimin e procedurave të prokurimit për studim-projektimin apo zbatimin e projektit për një ose disa institucione të arsimit të lartë. Në këto raste, çelja e fondit nga ministria përgjegjëse për financat bëhet pas paraqitjes së kërkesës nga njësia e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin.

### **Neni 17**

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës 1, që përmendet në nenin 11, të këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Të drejtat e përcaktuara në nenin 44, të ligjit nr.9636, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për rishpërndarjen e fondeve buxhetore përcaktojnë treguesit e faktit në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.

### **Neni 18**

Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2022, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve, është 35.9% e PBB-së. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të.

### **Neni 19**

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese për vitin 2023, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 54 555 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 50 353 milionë lekë;
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese deri në 4 202 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 469 853 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 396 231 milionë lekë;
- Stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore 72 872 milionë lekë;
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 750 milionë lekë.

## Neni 20

Në rast e mëposhtme:

- të emetimit të një eurobondi të ri, vlera e të cilit mund të jetë më e lartë sesa vlera orientuese prej 59 335 milionë lekësh;
- të një parablerjeje të mundshme të eurobondit ekzistues që maturohet në vitin 2025 që mund të jetë më e ulët sesa vlera orientuese prej 29 668 milionë lekësh;
- të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën e “mbështetjes buxhetore” nga institucionet financiare ndërkombëtare;
- të përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar,

kufijtë respektivë për huamarrjen totale neto, rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore dhe nivelin e vlerësuar të stokut total të borxhit publik, të përcaktuara në këtë nen dhe nenin 19, mund të tejkalohen deri sa shuma e vlerave të mëposhtme:

- Diferenca midis vlerës faktike të eurobondit të emetuar dhe vlerës orientuese prej 59 335 milionë lekësh.
- Diferenca midis vlerës orientuese të parablerjes së mundshme të eurobondit prej 29 668 milion lekësh dhe vlerës faktike të parablerjes, përfshirë edhe vlerën faktike zero që do të rezultonte në rast të mosbërjes së parablerjes.
- Vlera e kredisë në formën e “mbështetjes buxhetore” të disbursuar;
- Vlera e përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar;

Ndërkohë, niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2023 mbetet i pandryshuar sipas përcaktimit në nenin 1 të këtij ligji.

Këshilli i Ministrave mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe të mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore të planifikuara për atë vit buxhetor.

#### **Neni 21**

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

#### **Neni 22**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2023..

**K R Y E T A R I**

**LINDITA NIKOLLA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR BUXHETIN  
E VITIT 2023”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ



Seance Rreze  
JL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar "Aleanca per Ndryshim"

Tiranë, më .../.../ 2022

**Lënda:** Propozohet për shqyrtim dhe miratim një amendament në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2023"

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Ketu

E Nderuar Znj. Kryetare,

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim amendamentin në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2023", shoqëruar me relacionin përkatës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**DEPUTETE**

**Emilja KOLIQI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT

PËR  
NJË NDRYSHIM NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Znj. Emilja Koliqi propozon,

Në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në Tabelën 5 shoqëruese “Shpenzimet sipas institucioneve 2023”, Grupi 17, “Ministria e Mbrojtjes”, programi 10910 “Emergjencat Civile”, kapitulli 1 “Çelje nga buxheti”, në artikullin 604 “ Të tjera transfera korente të brendshme” vlera “800,000” të zëvendësohet me vlerën “2,600,000”.

**Neni 2**

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset e ligjit.

**RELACION**  
**PER AMENDAMENTIN**  
**PËR**  
**NJË NDRYSHIM NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**

Në pikën 1 të nenit 65 “ Buxheti i bashkive”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, parashikohet:

*1. Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.*

Shpenzimet për Buxhetin vendor, të parashikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” janë në vlerën 65,584 milionë lekë.

Por fondi i parashikuar tek Ministria e Mbrojtjes, në programin “Emergjenca Civile”, në artikullin 604 “ Të tjera transfertë korente të brendshme”, i destinuar për bashkitë, është vetëm 800 milion lekë.

Nga llogaritjet në respektim të dispozitave ligjore, 4% të totalit të buxhetit vjetor vendor, fondi i parashikuar në këtë zë, duhet të ishte 2.6 miliard lekë.

Për dy vite rresht 2020,2021, nuk u respektua ky nen i ligjit, duke mos i transferuar masën 4% të buxhetit NJQV-ve. Ky fond nuk u akordua as për fatkeqësinë natyrore COVID-19.

Nën presionin e krijuar nga tërmeti i vitit 2019, pandemia e COVID-19, situata e përmbytjeve të vazhdueshme në periudhën e dimrit, për herë të parë në vitin 2022, u parashikua fondi për bashkitë në shumën 1.131 milionë lekë.

Por edhe kjo vlerë e parashikuar në buxhetin e vitit 2022, nuk përkon me vlerën e llogaritur si 4% e buxhetit vendor total vjetor (sipas ligjit nr. 45/ 2019 “Për mbrojtjen civile”).

Me një llogaritje të thjeshtë, minimalisht bashkitë do të duhet të kishin përfutur rreth 2.4 miliardë lekë.

Mbivendosja në ushtrimin e funksioneve të transferuara, por të pafinancuara, veçanërisht në emergjenca civile, është një nga problemet kryesore të ushtrimit të këtij funksioni nga NJQV-të.

Ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësisë dhe kompetencave të të gjithë llojeve, dhe buxhetimi i tyre sipas parimit të mjaftueshmërisë financiare, janë hapat emergjent, që duhet të ndiqen.

Shqipëria, çdo vit po përballet me humbje të konsiderueshme, ndonjëherë shkatërruese, nga fatkeqësitë. Përmbytjet, tërmetet, zjarret në bimësi dhe në pyje, rrëshqitjet e tokës dhe rreziqet e tjera dhe pasojat e tyre kanë një ndikim të konsiderueshëm në komunitet, ekonomi, infrastrukturë dhe mjedis.

Nga përmbytjet e ndodhura në Shkodër në vitin 2018, vlera e perlllogaritur e ketyre demeve kapi vleren prej 310.974.940 lekë.

Nga përmbytjet e ndodhura në Shkodër në vitin 2021, vlera e perlllogaritur e ketyre demeve kapi vleren prej 801,661,519 lekë.

Por asnjë dëmshpërblim nuk pati për këto dëme.

Vlerat e parashikuara në buxhet janë shumë të ulëta në krahasim me dëmet që shkaktohen.

Njësitë e Vetqeverisjes Vendore janë ato që përballen në momentin e parë me fatkeqësinë, prandaj është i domosdoshëm akordimi i fondit të plotë prej 2.6 miliard lekë.

Mungesa e fondeve, çon në kapacitet të limituar për përballimin e situatave emergjente.

Fatkeqësitë shkaktojnë shumë humbje dhe dëme dhe ndikojnë negativisht në më shumë se një element social në zonën e goditur, duke shkaktuar kështu një degradim të standardit të jetesës dhe pamundësojnë progresin dhe prosperitetin e shoqërisë.

Ky fond mund të rialokohet nga fondi i parashikuar për investime, po në këtë program, të cilat nuk janë investime të mirëfillta si Blerje mallra Rezerve Shteti ushqimore, Mallra Rezerve Shteti Industrial, Blerje ushqimi per bageti, etj sipas tabelës së investimeve;

si dhe nga shpenzime të qeverisjes qendrore, pa cënuar nivelet e planifikuara të deficitit buxhetor.

**Emilja KOLIQI**

